



Министерство за образование и наука -Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

PLANIFIKIMI, PËRGATITJA, DHËNIA DHE PËRCJELLJA E DETYRAVE TË SHTËPISË NË KLASË TË PARË DHE TË KATËRT

Në përputhje me Konceptin e ri për arsimin fillor, si dhe reformat në arsimin fillor të cilat dalin nga ky dokument dhe që klasa e parë dhe e katërt nga ky vit shkollor 2021/2022 fillojnë me realizimin e programeve të reja mësimore. Programet e reja mësimore kanë qasje të re ndaj mësimdhënies ku përparësi kanë **përfitimi dhe nevojat e nxënësve** të cilat janë në qendër të orës mësimore. Risitë të cilat kanë të bëjnë me procesin e mësimdhënies në mes veti ndërlidhen në dhënien e detyrave të shtëpisë të cilat konsiderohen si njëra nga mënyrat për zhvillimin e mëvetësishëm të mësimin, përfitimi i shprehive dhe rregullshmëri në kryerjen e obligimeve si dhe përgatitja në drejtim të vetëarsimimit. Nga kjo dhe nevoja për qasje serioze gjatë planifikimit dhe kontrollimit të tij.

Faktorët kryesorë të përcaktimit të detyrës së shtëpisë janë: mosha e nxënësve dhe zhvillimi i tyre kognitiv si dhe kushtet në të cilët mësojnë – në shkollë dhe shtëpi. Detyra e shtëpisë është vazhdimësi e punës në shkollë dhe duhet të: udhëzohet në përmbledhjen e konkluzave, të jetë e ndërlidhur dhe bazuar në përvojën e nxënësit, të kërkohet nga nxënësi përvetësimi i njohurive nga niveli më i lartë. Gjatë planifikimit duhet pasur kujdes në nivelin e peshës (niveli i cili përputhet me njohuritë dhe aftësitë e nxënësit) si dhe llojllojshmëria e detyrave të dhëna (detyra komplekse, përmbledhja e informatave, përmbledhja e materialeve, ndjekja e dukurive dhe proceseve, ese).

Gjatë dhënies së detyrave të shtëpisë, mësimdhënësi/mësimdhënësja duhet të krijojë bindje se nxënësit i kanë kuptuar udhëzimet dhe të gjithë nxënësit do t'i punojnë detyrat e shtëpisë në mënyrë të pavarur. Për atë qëllim, gjatë dhënies së detyrave të shtëpisë, mësimdhënësi/mësimdhënësja duhet të jetë i/e sigurt se:

- qëllimet janë të përkufizuara;
- kërkesat për çdo nxënës/nxënëse janë të qarta;
- detyrat e shtëpisë janë në përputhje me nivelin e peshës së tyre;
- detyrat e shtëpisë nuk do t'iu marrin shumë kohë nxënësve në shtëpi;

Gjithashtu, mësimdhënësi/mësimdhënësja duhet të:

- sigurojë listën e materialeve të duhura për t'i punuar detyrat e shtëpisë;
- ketë përgatitur detyra plotësuese për nxënësit të cilët dëshirojnë të sfidohen me njohuri shtesë;
- ketë përgatitur detyra të specializuara për nxënësit të cilët kanë probleme në një fushë të caktuar;

Segment i rëndësishëm është ndjekja dhe vlerësimi i detyrave të shtëpisë. Mësimdhënësi/mësimdhënësja duhet të përcjellë kryerjen e detyrave të shtëpisë të çdo nxënësi/nxënëseje, në kohë duhet dhënë informata kthyesë për të mësuarit dhe të arriturat e tyre, ta nxisë në vetëreflektim dhe vetëvlerësim, t'i ndihmojë që t'i vendosë qëllimet e të mësuarit dhe ta udhëzojë në arritjen e tyre.



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

Evidentimi dhe dokumentimi në përparimin e të arriturave të nxënësve në detyrat e shtëpisë u mundëson mësimdhënësve të bëjnë reflektim në punën e tyre, duke e vlerësuar efikasitetin e qasjeve të caktuara të procesit mësimor, nga aspekti i kontributit të tyre në të arriturat e qëllimeve të parashtruara në të mësuarit. Dokumentimi i përparimit dhe të arriturat e nxënësve u mundëson mësimdhënësve t'i përfshijnë prindërit/tutorët në analizën më objektive në të arriturat e tyre, por edhe në hapat e mëtutjeshëm në mësimnxënien e fëmijëve të tyre.

Klasa e parë

Në pjesën e qëndrimit në shkollë kur nxënësit përkushtohen dhe realizojnë edhe aktivitete të tjera, mësimdhënësi planifikon dhe realizon aktivitete nëpërmjet mënyrave të ndryshme nxënësit ta përsërisin, ushtrojnë apo në mënyrë plotësuese do ta bisedojnë ose do ta interpretojnë atë që e kanë mësuar atë ditë. Veçanërisht duhet theksuar se nxënësit nga kjo moshë me rëndësi është të zhvillojnë funksionet psikologjike të nevojshme për kryerjen e aktiviteteve frytdhënëse e jo vetëm në trajnimin e aftësive. Sipas kësaj, për nxënësit e klasës së parë nuk parashihet dhënia e detyrave të shtëpisë. Në vend të kësaj mësimdhënësi/mësimdhënësja me nxënësit zhvillojnë këto aktivitete:

- lexim dhe dëgjim – nxënësit duhet të mësojnë të dëgjojnë me vëmendje, dhe më pas për të njëjtën të dinë të bisedojnë. Aktivitetet e ndërlydhura me të dëgjuarit dhe bisedat për tekstet adekuate për moshat dhe të përfitimit të nxënësve të klasës së parë është fillim i mirë për zhvillimin e përfitimit dhe dëshirës për të lexuar. Qëndrimi pozitiv ndaj të lexuarit do të lindë nga aktivitetet mirë të menduara njësoj si dhe leximi i zgjedhur;
- aktivitete për prezantimin e të kuptuarit – nxënësit duhet të inkurajohen që të shprehën në media i cili iu përshtatet: vizatimi, ngjyra, lëvizja etj;
- aktivitete për të shprehur ndjenjat të cilët i kanë nxënësit deri sa punojnë diçka në shkollë;
- aktivitete të ndërlydhura me zhvillimin e memories së imazheve (fotografive) vizuale të shkronjave/numrave. Mësimdhënësi organizon aktivitete në të cilën do të kërkon nga nxënësi/nxënësja të gjejë shkronja /numra të ndryshme në tastierën e kompjuterit, në ilustrime, në librin shkollor. Gjithashtu, është mirë që nxënësi t'i krijon shkronjat dhe numrat duke shfrytëzuar plastelinë dhe materiale tjera;
- aktivitete për lexim të përgjithshëm gjatë gjysmëvjetorit të parë, leximi i mbishkrimeve, reklamave e shitoreve ose dhe të targave të automjeteve;
- aktivitete në të cilat, përveç që parashtrihen pyetje të tipit të hapur – njohja e të saktës dhe të pa saktës si dhe dhënia e përgjigjeve ekzakte, të parashtrihet pyetja pse me inkurajim për sqarim. Për shembull *“Pse katër plus katër është e barabartë me tetë?”*
- aktivitete të cilat iu mundësojnë nxënësve të përfitojnë përvojë për atë që mësojnë, bëhen më të vetëdijshëm për njohurit e tyre dhe kuptojnë se shkolla nuk është vendi i vetëm për të arritur apo marrë njohuri dhe për të mësuar diçka. *Për shembull, nxënësi mbjellë farën dhe kujdeset që të rritet.*



Министерство за образование и наука -Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

Për nxënësit e klasës së parë nuk janë të planifikuara aktivitete për në shtëpi, por megjithatë, prindërit/tutorët si ndër faktorët në trekëndëshin mësimdhënës, nxënës, prindër është e nevojshme të jetë në rrjedhë me atë që po ndodhë me fëmijën dhe përparimin e tij si dhe problemet që eventualisht mund të ballafaqohen. Për atë qëllim, komunikimi i përhershëm me prindërit/tutorët është faktor i rëndësishëm dhe i domosdoshëm.

Klasa e katërt

Për nxënësit e klasës së katërt janë të parapara detyra shtëpie, në drejtim të arritjes së standardeve nacionale, rezultatet nga të mësuarit, të harmonizuara për moshën e nxënësve dhe kohën e paraparë për realizimin e tyre.

Pjesa më e madhe e aktiviteteve të planifikuara rekomandohet të realizohen në shkollë, pjesa e mbetur në shtëpi, të njëjtat të mos marrin kohë më tepër se 40 minuta. Aktivitetet duhet çdo ditë të jenë të ndryshme dhe të përfshijnë të gjitha lëndët (për këtë nuk mendohet se çdo ditë duhet pasur aktivitete për çdo lëndë nëpërmjet të cilëve do të përsëritet ajo që është mësuar, por në atë pjesë ku mësimdhënësi vlerëson se ka nevojë ose është përfitim për nxënësit).

Propozim aktivitete që duhet realizuar me nxënësit e klasës së katërt:

- aktivitete ku e vendosin nxënësin/nxënësen në situatë problematike e cila e shpie kah thellimi i të mësuarit të nxënësit/nxënësës, me çka kërkohet të menduarit dhe qëndrimi i tij/saj i argumentuar, me çka do të sigurohej aktivitet dhe angazhim më i madh. Shembull, nxënësit mund të grumbullojnë të dhëna për projekte më afatgjata, varësisht nga njohuritë dhe shkathtësitë e tyre paraprake dhe përfitimet e tyre. Për të inkurajuar mendim kreativ dhe kritik dhe inkurajim të proceseve më të lartë të menduarit, detyrat e shtëpisë duhet të jenë në formë hulumtimi/kërkimi për ndonjë problematikë, hipoteza, projekte të caktuara, zgjidhja e situatave problematike dhe detyra të hapura etj. I tërë aktiviteti i nxënësve duhet të jetë orientuar në vetëzbulimin e nocioneve, proceseve dhe dukurive;
- përfshirja e familjes në detyrat e shtëpisë, duhet bërë sipas perceptimit të kushteve në të cilat nxënësit jetojnë dhe me respektimin e specifikave të tyre nga karakteri social dhe material dhe posedimi i teknologjisë digjitale;
- dhënia e numrit të përshtatshëm të detyrave të shtëpisë: nxënësit nuk duhet të marrin udhëzime për detyra shtëpie: *“Zgjidhni detyrat prej 1 deri në 10, në faqen 25 në librin e Matematikës”*. Në vend të kësaj, mundet të përzgjidhen tre ose katër probleme, të cilat mundësojnë aplikimin e aftësive; ose t’iu ofrohet nxënësve që ata ta bëjnë përzgjedhjen e detyrës së shtëpisë; ose të kërkohet që të shkruajnë tri probleme në matematikë, me vetë përballjen me problemin, nxënësi mendon për mënyrën e zgjidhjes së tij.
- leximi i materialit me të cilën ballafaqohen në jetën e përditshme: reklamat, broshurat, fletushkat, oraret, repertorët dhe vrojtimi i informatave nga ata. Në këtë mënyrë nxënësit më



Министерство за образование и наука -Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

lehtë munden të arrijnë në rezultatet e pritura nga të mësuarit derisa e përjetojnë atë që e kanë mësuar si relevante dhe e dobishme, respektivisht si diçka që mund ta sjellin në relacion me jetën e përditshme;

- dëgjimi, leximi dhe shpjegimi i teksteve nga libri, artikuj gazetareske, blloqe dhe sajte të verifikuara;
- detyrat e shtëpisë të cilat ua mundësojnë nxënësve që t'i integrojnë njohuritë nga më shumë lëndë dhe t'i aplikojnë në zgjidhjen e problemeve nga situatë e përditshme, si dhe t'i zhvillojnë potencialet e tyre dhe aftësitë krijuese. Për shembull, nxënësit hulumtojnë/kërkojnë cilat mbeturina janë më të dëmshëm për natyrën dhe ambientin e tyre.

Me digjitalizimin e arsimit hapen mundësi të reja për krijimin e aktiviteteve të ndryshme të cilat duhet të jenë në bashkërenditje me kompetencat digjitale të nxënësve të cilët dalëngadalë do të përparojnë/zhvillohen. Rrjedhimisht edhe detyrat e shtëpisë mund të planifikohen dhe t'iu jepen nga mësimdhënësit nga ndonjë platforme digjitale.

Udhëzime të hollësishme për mënyrën e planifikimit dhe realizimit të detyrave të shtëpisë në distancë mund të gjinden në Udhëzimin për metodikën e të mësuarit në distancë në arsimin fillor dhe të mesëm, në dispozicion në linkun e mëposhtëm:

<https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2021/03/Upatstvo-za-metodika-za-nastava-na-dalecina-1.pdf>